

L I G J
Nr.9438, datë 27.10.2005

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES USHTARAKE GRANT NDËRMJET KËSHILLIT
TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS
SË TURQISË”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ushtarake grant ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4694, datë 11.11.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

MARRËVESHJE USHTARAKE GRANT
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË
SË REPUBLIKËS TË TURQISË

Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Turqisë, duke riafirmuar dhe një herë marrëdhëniet e tyre të gjata miqësore,

duke iu referuar Marrëveshjes së bashkëpunimit në fushën e trajnimit ushtarak, teknikës dhe shkencës datë 29.7.1992 dhe Marrëveshjes së bashkëpunimit dhe trajtimit ushtarak të datës 19.11.1992,

me qëllim forcimin e bashkëpunimit ushtarak dhe kontributit për ristrukturimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Qeveria e Republikës së Turqisë do t'i dhurojë 1 320 000 (një milion e treqind e njëzet mijë) lira turke të reja, ekuivalente në dollarë amerikanë, Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Granti do të jetë i disponueshëm nga viti 2005.

Neni 2

Granti prej 1 320 000 (një milion e treqind e njëzet mijë) lira turke të reja, ekuivalente në dollarë amerikanë, do të sigurohet si materiale dhe shërbime, në përputhje me rregullat në fuqi të Republikës së Turqisë.

Neni 3

Granti prej 1 320 000 (një milion e treqind e njëzet mijë) lira turke të reja, ekuivalente në dollarë amerikanë, do të realizohet në përputhje me protokollin e zbatimit logjistik, i cili do të

nënshkruhet ndërmjet zyrtarëve të të dyja palëve të referuara në këtë Marrëveshje.

Neni 4

Republika e Shqipërisë bie dakord të mos ia transferojë titujt, materialet, shërbimet një vendi ose pale tjetër, pa marrë më parë miratimin e Republikës së Turqisë, e cila ka dhënë këtë grant.

Neni 5

Marrëveshja do të hyjë në fuqi datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim nga palët, lidhur me përfundimin e të gjitha procedurave të brendshme për ratifikim, në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar, dhe do të jetë në fuqi deri sa të gjitha materialet e shërbimet të specifikuar në protokollin zbatues t'i jenë dhënë Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës të Shqipërisë.

Marrëveshja grant do të zbatohet nga Ministria e Mbrojtjes në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe nga Shtabi i Përgjithshëm turk në emër të Republikës turke.

Çdo marrëveshje e lindur gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet me diskutime dhe bisedime dypalëshe.

Kjo Marrëveshje është përgatitur në shqip, turqisht e anglisht. Në rast të mosmarrëveshjeve, lidhur me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, teksti anglisht i marrëveshjes do të jetë prioritar.

Kjo marrëveshje është nënshkruar në Tiranë, më 5 shtator 2005.

Në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë	Në emër të Qeverisë së Republikës të Turqisë
LUAN HOXHA Gjeneral Major Zëvendës shef i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura	ALI AKDOGAN Gjeneral Brigade Shef i Sektorit të Menaxhimit të Burimeve dhe Planifikimit të Mbrojtjes në Shtabin e Përgjithshëm